



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:057729

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05760141

KPPP.nr.163/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Banka për Biznes SH.A., me seli në rr. “Enver Maloku”, nr.108, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Debt Loan Recovery SH.P.K., kundër debitorëve 1. Auto Sallon “Kushtrimi”, me numër të biznesit: 70224318, me seli në Vushtrri dhe 2. NTSH “Euro Color” me numër të biznesit: 70324479, me seli në fshatin Stanovc i Epërm, në Vushtrri, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.262/23 të datës 17.10.2023 të Përmbartuesit Privat Sefer Arifi, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datën 30.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit NTSH “Euro Color”, me seli në Vushtrri, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.499/22 të datës 19.12.2022 të Përmbartuesit Privat Sefer Arifi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.499/22 i datës 19.12.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Arifi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Banka për Biznes SH.A., me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv - Ujdia Gjyqësore e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.581/19 të datës 28.03.2022, ka nxjerr

urdhrit përbarimor P.nr.499/22 me datën 19.12.2022, me të cilin janë detyruar debitorët Auto Sallon “Kushtrimi” dhe NTSH “Euro Color” që sipas kësaj urdie gjyqësore të lartcekur kreditorit t’ia kthejnë borxhin në shumën prej 12,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 60.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve duke filluar nga dita e pranimit të urdhit përbarimor, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorëve, si dhe me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme të debitorëve.

Debitori NTSH “Euro Color”, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, nuk i ka kundërshtuar pretendimet e kreditorit lidhur me pagimin e borxhit, por ka theksuar që arsyeja e mos pagesës qëndron për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore të debitorit dhe kontrolleve mjekësore jashtë vendit të cilat i ka dhe se i njëjti nuk ka mjete financiare për pagesën e këtij borxhi. Gjykatës i ka propozuar që të aprovet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përbarimor dhe të pezullohet procedura.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se propozimi për përbarim bazohet në dokumentin e besueshëm me titull ekzekutiv Urdia Gjyqësore e Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër EK.nr.581/19 të datës 28.03.2022 në bazë të së cilës së bashku me debitorët ishin pajtuar që nga data e arritjes së urdisë së datës 28.03.2022 e deri me datën 30.05.2022, debitorët të paguajnë borxhin në emër të kthimit të kredisë në shumën prej 12,000.00 € si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 60 € në emër të taksës për padi, por meqenëse debitorët nuk e kanë paguar borxhin ndaj kreditorit, kreditori ka iniciuar procedurën përbarimore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, të lejohet urdhri përbarimor dhe të vazhdohet me procedurën përbarimore ndaj debitorëve deri në përmbushjen në tërësi të obligimit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet

urdhri përbarimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përbaruesit Privat P.nr.499/22 të datës 19.12.2022, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përbarues (titullit ekzekutiv) – Ujdia Gjyqësore e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.581/19 e datës 28.03.2022.

Sipas dokumentit përbarues (titullit ekzekutiv) - Ujdia Gjyqësore e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.581/19 të datës 28.03.2022, debitori është detyruar që kreditorit të t'ia paguaj në emër të borxhit, shumën prej 12,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 60.00 € në emër të taksës për padi.

Gjykata gjeti se dokumenti përbarimor - Ujdia Gjyqësore e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.581/19 të datës 28.03.2022, është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit-vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përbaruese siç janë: *“vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbarrim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv - Ujdia Gjyqësore i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarrues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që dokumenti përmbarrimor, është i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbarrje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbarrjes së këtij detyrimi.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarrimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë -Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.163/23, datë 30.05.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.